

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 205-23-11085-5-1-1

Sa i përket tenderit për: "NDËRTIMI I RRUGËS PRIZREN - KUFIRI ME MAQEDONIN E VERIUT (TETOVË), SEGMENTI STRUZHË - KYÇJA NË AUTO-UDHËN DR.IBRAHIM RUGOVA NË PRIZREN - JUG, L=20.350 KM,; LOTI 1 - L= 6+913.73 KM; LOTI 2 = L= 6+525.00 KM; LOTI 3 = L= 6+911.27 KM"

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Grupi i OE: "DAMASTION PROJECT" SH.P.K. & "COMPANYA ESKAVATORI" SH.P.K. & "B FAMIS" SH.P.K. & "ESKAVATORI MK" L.L.C.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. ISA KASTRATI P.N. – 10000 PRISHTINË – RKS

(Adresa)

PRISHTINË

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+383 45 213 213

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

VISAR TAHIRI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[damastionproject@gmail.com](mailto:damastionproject@gmail.com)

(Adresa elektronike)

19.04.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrim dhe vulë)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për Kontratë..... 13.10.2023;
- Korrigjim - Shtyerje e afatit të dorëzimit..... 21.11.2023;
- Hapja e Tenderit..... 30.11.2023;
- Kërkesë nga AK për dorëzimin e Dëshmime të Përshtatshmërisë..... 08.02.2024;
- Dorëzimi i dëshmime të Përshtatshmërisë nga Konzorciumi jonë..... 12.02.2024;
- Kërkesë për Sqarim drejtuar AK, për vonesat e Formularit B58..... 04.03.2024;
- Pranimi i Letrës Standarte për Operatorin e Pa Suksesshëm..... 03.04.2024;
- B58 – Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues..... 03.04.2024;
- Raporti i Rivlerësimit i aktivitetit të Prokurimit..... 03.04.2024;
- F02 Kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit të AK..... 08.04.2024;
- Vendimi i AK mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim..... 15.04.2024;

Kriteret për dhënie të Kontratës:

- Objekti i kontratës është i ndare në:..... 3 pjesë (lote);
- Numri maksimal i Pjesëve që mund të shpërblehet një tenderues është:..... Nië (1);
- Kriteri për dhënie të Kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët:..

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëturjeshme në aktivitetin e prokurimit?

OEI Pa Suksesshëm

Po

Jo

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

- F02 Kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit të AK..... 08.04.2024;
- Vendimi i AK mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim..... 15.04.2024;

#### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura të LPP-së Nr.04/L-042 të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 1 Qëllimi

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 11 Informatat Sekrete Afariste

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60.A Përparësia për Ofertuesit Vendor (Nr.04/L-237)

Neni 65 Përshtatshmëria Kandidatëve ose Tenderuesëve

Neni 67 Provat Shkresore

Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 71 Grupi i Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

Neni 72 Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë (Nr.05/L-068)  
Neni 108/A Zgjidhja Preliminare e Mosmarrëveshjeve (Nr.05/L-068)

Dispozitat e shkelura të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik:  
Neni 25 Kriteret e Përzgjedhjes  
Neni 26 Grupi i Operatorëve Ekonomik  
Neni 38 Sqarimi i Tenderëve  
Neni 39 Krijimi i Komisioneve Vlersuese të Tenderve  
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve  
Neni 45 Procedurat e Prokurimit

Dispozitat e shkelura të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik  
8.5. Kriteret e përzgjedhjes  
10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet "1"

*Ligji Nr.05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 të LPP-së  
Neni 108/A*

*Zgjidhja Preliminare e Mosmarrëveshjeve*

*9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara.*

Në Vendimin mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk e ka arsyetuar refuzimin e dhjetë pretendimeve të paraqitura në Kërkesën e Konzorciumit tonë: "Damastion Project" SH.P.K. & "Companya Eskavatori" SH.P.K. & "B Famis" SH.P.K. & "Eskavatori MK" L.L.C.

Respektivisht AK nuk i ka shqyrtuar fare argumentet dhe faktet tona, lidhur me shkeljet e dispozitave të LPP-së në këtë aktivitet të prokurimit.

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

*Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr.05/L-068, Neni 108/A, duke mos e arsyetuar me shkrim refuzimin e dhjetë argumenteve dhe fakteve të paraqituara në Kërkesë për Rishqyrtim.*

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet “2”

*Rregullore 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 45 Procedurat e Prokurimit  
Procedura për Ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve*

45.31 Raporti i vlerësimit përmban diskutimet, vlerësimet e ekzaminimit të tenderëve dhe i njëjti i dorëzohet ZPP për aprovim. Para se Raporti i Vlerësimit të aprovohet, ZPP kërkon nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës dëshmitë për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë të specifikuar në Dosje të Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Pas pranimit të dëshmimeve të pranueshmërisë, ZPP nënshkruan raportin e Vlerësimit dhe e ngarkon në platformë.

45.32 Pas miratimit të raportit Vlerësues nga ZPP, AK do të përgatitë dhe publikoj Formularin B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK në platformën e prokurimit elektronik.

Autoriteti Kontraktues me datë 08.02.2024 ka kërkuar nga Konzorciumi jonë “Damastion Project” SH.P.K. & “Companya Eskavatori” SH.P.K. & “B Famis” SH.P.K. & “Eskavatori MK” L.L.C., që më së largu deri me datë 12.02.2024 të dorëzohen në formë elektronike dhe fizike dëshmitë lidhur me Kërkesat e Përshtatshmërisë dhe Sigurimin e Tenderit Original, të cilat kërkohen vetëm nga FITUESI I TENDERIT.

Me datë 12.02.2024 kemi dorëzuar në formë elektronike dhe fizike të gjitha dëshmitë sipas afatit dhe kërkesës së AK-së:

- Vërtetimat nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), për secilin Anëtar të Konzorciumit;
- Vërtetimat nga Gjykata Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike, për secilin Anëtar të Konzorciumit;
- Vërtetimat nga Gjykata Kompetente, për secilin nga Drejtuesit dhe Menaxherët e Anëtarëve të Konzorciumit;
- Sigurimin e Tenderit Original.

Me datë 04.03.2024 kemi kërkuar Sqarim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues për vonesën në dërgimin e formularit B58 Njoftimit mbi Vendimin e AK, ashtu siç e parashih Rregullorja Nr.001/2022 – Neni 45, paragraf 45.31 dhe paragraf 45.32.

Me datë 03.04.2024, pesëdhjetë e një ditë (51 ditë) pasi kemi dorëzuar me sukses dëshmitë lidhur me kërkesat e Përshtatshmërisë dhe Sigurimin Original të Tenderit (dokumente që kërkohen vetëm për FITUESIN), pa asnjë Sqarim nga AK, kemi pranuar Letrën Standarte për Operatorin e Pa Sukseshshëm.

Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me Rregulloren Nr.001/2022, Neni 45 Procedurat e Prokurimit, Pika 45.31 dhe 45.32, me datë 07.03.2024, pasi ka pranuar me sukses nga Konzorciumi jonë dëshmitë e Përshtatshmërisë dhe Sigurimin Original të Tenderit, dokumente që kërkohen vetëm për FITUESIN, e ka kthyer këtë Aktivitetet të Prokurimit në RI VLERËSIM.

Sipas LPP-së në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit, vetëm dështimi i dorëzimit të dëshmimeve të Përshtatshmërisë nga FITUESI e lejon Autoritetin Kontraktues të vazhdojë me Tenderuesin e listuar në vendin e dytë, e asesi të shkojë në Ri Vlerësim të Aktivitetit.

Si rrjedhojë e mos respektimit të Procedurave të Prokurimit të përcaktuara në Rregullore Nr.001/2022 ka ndodhë situata si kjo: “Tenderuesi Fitues, që ka dërguar me sukses dëshmitë e Përshtatshmërisë dhe Sigurimin Original të Tenderit, merr Njoftimin nga AK si Operator i Pa Suksesshëm”.

LPP nuk parasheh këtë lloj situatë në mes Autoritetit Kontraktues dhe OE:

“Nëse OE nuk i dorëzon me sukses dëshmitë e përshtatshmërisë për Fituesin:

**“I konfiskohet Garancioni në vlerë prej 250.000.00 eu”.**

Nëse OE i dorëzon me sukses dëshmitë e përshtatshmërisë për Fituesin:

**“Autoriteti Kontraktues shkon në Ri Vlerësim”.**

Nga Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe nga Raporti i Ri-Vlerësimit informohemi se për Lot 2 Kontrata i është dhënë një Grupi tjetër Ekonomik në kundërshtim me Raportin e Vlerësimit – Komisioni i Parë:

Grupi i Operatorëve Ekonomik Fitues: “Pricom” SH.P.K. & “Metag Insaat Ticaret” A.Ş. & “FS C ING” SH.P.K. & “Jaha Solar” SH.P.K.

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

*Autoriteti Kontraktues e ka kthyer këtë Aktivitetin të Prokurimit në Ri-Vlerësim në një fazë që nuk lejohet me Procedurat e Prokurimit të përcaktuara në Rregullore Nr.001/2022; Neni 45 Procedurat e Prokurimit, Parag. 45.31. “Raporti i vlerësimit përmban diskutimet, vlerësimet e ekzaminimit të tenderëve dhe i njëjti i dorëzohet ZPP për aprovim. Para se Raporti i Vlerësimit të aprovohet, ZPP kërkon nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës dëshmitë për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë të specifikuara në Dosje të Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Pas pranimit të dëshmimeve të pranueshmërisë, ZPP nënshkruan raportin e Vlerësimit dhe e ngarkon në platformë” dhe Neni 45 Procedurat e Prokurimit, Parag. 45.32. “Pas miratimit të raportit Vlerësues nga ZPP, AK do të përgatitë dhe publikoj Formularin B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK në platformën e prokurimit elektronik”.*

*AK duke vepruar në kundërshtim me Procedurat e Prokurimit të përcaktuara në Rregulloren Nr.001/2022, Neni 45, Parag 45.31 dhe Parag. 45.32, ka krijuar këtë situatë: “Tenderuesi Fitues, që ka dërguar me sukses dëshmitë lidhur me kërkesat e Përshtatshmërisë dhe Sigurimin Original të Tenderit, në hapin tjetër, pranon nga AK Letrën Standarte për Operator të Pa Suksesshëm”.*

*\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet esenciale të LPP-së, në pikën 2.*

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet “3”

*Ligjin për qasje në dokumente publike Nr.06/L-081 dhe 03/L-215*

*Neni 1 Qëllimi*

*Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.*

Me datë 03.04.2024 kemi bërë Kërkesë për qasje në dokumenta zyrtare për këtë aktivitet të prokurimit.

Me datë 05.04.2024 Autoriteti Kontraktues na ka lejuar qasjen në dokumente zyrtare.

- Autoriteti Kontraktues nuk na ka lejuar të kemi qasje në Raport të Vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit – dokument zyrtar i hartuar nga institucioni publik.
- Autoriteti Kontraktues nuk na ka lejuar të kemi qasje në dëshmitë e Nenit 65 “Përshtatshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesëve” të Grupit të Operatorëve Ekonomik Fitues: “Pricom” SH.P.K. & “Metag Inshaat Ticaret” A.Ş. & “FS C ING” SH.P.K. & “Jaha Solar” SH.P.K.

Me datë 06.04.2024 kemi përsëritur Kërkesën për qasje në dokumentin publik “Raporti i Vlerësimit” dhe për qasje në dëshmitë e Përshtatshmërisë (Neni 65) të Grupit të Operatorëve Ekonomik Fitues në Lot 2. Qasja në këto dokumente publike nuk është lejuar nga AK as pas përsëritjes së Kërkesës.

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

*Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Nr.06/L-081 dhe 03/L-215, Neni 1, duke mos lejuar qasje në dokumentin e hartuar nga institucioni publik: “Raporti i Vlerësimit i këtij aktiviteti të prokurimit” dhe dispozitat e LPP-së, Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës dhe Neni 11 Informatat Sekrete Afariste, duke mos lejuar qasje në informatat e Nenit 65 “Përshtatshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesëve” të Grupit të Operatorëve Ekonomik Fitues.*

*\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsytim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet esenciale të LPP-së, në pikën 3.*

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet “4”

*Rregullore Nr.001/2022, Për Prokurimin Publik*

*Neni 25 Kriteret e Përzgjedhjes*

*25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin Autoriteti Kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të AK-së për synimin e dhënies së Kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.*

ZPP në formularin e Raportit të Ri-Vlerësimit ku duhet të plotësojë me “PO” ose “JO” dorëzimin me sukses të dëshmitë të Përshtatshmërisë nga OE Fitues, e ka lënë të zbrazur rubrikën, duke konfirmuar mos dorëzimin e tyre nga OE Fitues.

Rubrika e pa plotësuar me “PO” nga ZPP është pika d) Vërtetim nga një Gjykatë Kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxherat e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme

Prandaj ekziston dyshimi i bazuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik Fitues: “Pricom” SH.P.K. & “Metag İnşaat Ticaret” A.Ş. & “FS C ING” SH.P.K. & “Jaha Solar” SH.P.K., kanë dështuar t’i përmbushin dëshmitë në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë.

*\*Dëshmia nga neni 65, është e klasifikuar nga OE si Sekret Afarist.*

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

*Ekziston dyshimi i bazuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik: “Pricom” SH.P.K. & “Metag İnşaat Ticaret” A.Ş. & “FS C ING” SH.P.K. & “Jaha Solar” SH.P.K. janë shpërblyer me kontratë nga AK, duke mos i përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së Nr.04/L-042, Neni 65 Përshtatshmëria Kandidatëve ose Tenderuesëve dhe me Rregulloren Nr.001/2022 Neni 25 Kriteret e Përzgjedhjes, Paragrafi 25.9. “Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së”.*



## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet "5"

Kriteri në FDT:

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik - Nr. 11.1;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

b. Një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

c. Një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit.

Udhëzuesi Nr.001/2023 për Prokurimin Publik

10. Sqarimi i Tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

"Mungonë Deklarata e nënshkruara nga secili Anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes" Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm – Kusht Administrativ".

Në paragrafin e parë të Marrëveshjes së Konzorciumit Fitues ceket se Marrëveshja në mes Anëtarëve është arritur në Prishtinë, me datë 30.11.2023. Edhe pse të gjithë anëtarët e Konzorciumit thuhet se ishin prezent, Marrëveshja nuk posedon vulë dhe nënshkrim origjinal të Anëtarit të Konzorciumit "Metag Insaat Ticaret" A.Ş. me seli në Turqi.

Asnjë dokument i Anëtarit të Konzorciumit "Metag Insaat Ticaret" A.Ş. me seli në Turqi nuk posedon vulë dhe nënshkrim origjinal, përfshi: Deklaratat e Pjesëmarrjes, Deklaratat e Përgjegjësisë dhe Deklaratat për Caktimin e Liderit të Grupit.

Faktet:

- Te Aneksi 3. "Kërkesa për Konfidencialitet", janë zhdukur shkronjat ekzistuese të dokumentit që kanë mbetur nën nënshkrim dhe vulë. Shihet qartë se vula dhe nënshkrimi, përmes programeve kompjuterike, janë prerë dhe bartur në formatin e fotografisë nga ndonjë dokument tjetër.
- Në dy dokumente të ndryshme, te "Lista e Kontratave" dhe te "Kërkesa për Konfidencialitet" është vendosur nënshkrimi identik, mbi vendin identik mbi vulë. Vetëm opsioni kompjuterik "copy-paste" e mundëson një gjë të tillë.
- Te "Deklarata nën Betim" është ndërhyrë në formatin e tabelës të publikuar në DT. Është formuar rubrikë e re, e pëbashkët për vulë dhe nënshkrim, meqenëse ka munguar mostra kompjuterike e nënshkrimit të ndarë nga vula, siç është kërkuar në tabelën e DT.
- Te "Marrëveshja e Konzorciumit" katër nënshkrimet e anëtarëve janë vendosur afër njëri tjetrit dhe vërehet qartë dallimi i këtijë nënshkrimi me nënshkrimat tjerë origjinal.

Dispozitat e shkelura të LPP-së:

Autoriteti Kontraktues duke e shpërblyer me Kontratë një Grup të OE të papërgjegjshëm ka shkelur dispozitat e LPP-së Nr.04/L-042, Neni 71 Grupi i Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik, Neni 67 Provat Shkresore, kriteret e FDT-së dhe Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik "Mungonë Deklarata e nënshkruara nga secili Anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes" Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm – Kusht Administrativ".

\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet e dispozitave të LPP-së, në pikën 5.

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet “6”

*Kriteri në FDT:*

*Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik - Nr. 11.1;*

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

*a. Një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;*

*Neni 71 i LPP-së Nr.04/L-042*

*Grupi i Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik*

*a. Një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.*

Grupi i Operatorëve Ekonomik Fitues: “Pricom” SH.P.K. & “Metag İnşaat Ticaret” A.Ş. & “FS C ING” SH.P.K., në Pikën 12 të Marrëveshjes së Konzorciumit kanë deklaruar qartë se: **“12. Ekzekutimi i Kontratës është përgjegjësi e Anëtarit Lider”.**

Sipas kësaj pike të Marrëveshjes Anëtarët e tjerë të Grupit nuk janë **“bashkërisht”** përgjegjës për ekzekutimin e Kontratës. Ata kanë deklaruar qartë se përgjegjësia për ekzekutimin e kontratës është **“individuale”** e Liderit të Konzorciumit.

Në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, Nenin 71, ku kërkohet një deklaratë e qartë e të gjithë anëtarëve të grupit që përgjegjësia për ekzekutimin e kontratës të jetë bashkërisht dhe individualisht.

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

*Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-së Nr.04/L-042, Neni 71 Grupi i Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik duke e shpërblyer me Kontratë një Grup të Operatorëve Ekonomik të Pa Përgjegjshëm të cilët deklarojnë qartë se përgjegjësia e ekzekutimit të kontratës është përgjegjësi “individuale” e Liderit të Konzorciumit.*

*\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsytim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet e dispozitave të LPP-së, në pikën 6.*

## **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet “7”**

*Kriteri në FDT:*

*Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar - Nr. 8.1 dhe 8.2;*

*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se:*

*Pjesen e II-te 34,000,000,00 euro*

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

*Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit*

*Rregullore Nr.001/2022, për Prokurimin Publik*

*Neni 40.6 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

*Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:*

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të DT;*
- b. është në pajtueshmëri me termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;*
- c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e për zgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.*

Ekziston dyshimi i bazuar se Konzorciumi Fitues, qarkullimin vjetor për tri vitet e fundit në vlerë prej 34,000,000.00 euro e ka dëshmuar përmes Anëtarit të Konzorciumit “Metag İnşaat Ticaret” A.Ş. me seli në Turqi. Anëtarët vendor të Konzorciumit nuk e plotësojnë këtë kriter.

Çdo kriter i plotësuar përmes këtij Anëtari, me Marrëveshje të pa nënshkruar të Konzorciumit, do të duhej të verifikohet dhe të konstatohet që ka përmbush në mënyrë specifike kriteret e për zgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit, sipas Rregullores Nr.001/2022, Neni 40.6 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pika “c”.

*\*Dëshmia është e klasifikuar nga OE si Sekret Afarist.*

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

*Ekziston dyshimi i bazuar se Konzorciumi fitues “Pricom” SH.P.K. & “Metag İnşaat Ticaret” A.Ş. & “FS C İNG” SH.P.K. & “Jaha Solar” SH.P.K., nuk i ka përmbush kërkesat minimale të përcaktuara në FDT Nr.8.1 dhe 8.2 për qarkullimin vjetor në tri vitet e fundit “Deklaratat Tatimore Vjetore për tri vitet e fundit”.*

*\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet e dispozitave të LPP-së, në pikën 7.*

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet “8”

*Kriteri në DT:*

*Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar - Nr. 8.1 dhe 8.2;*

*Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (lideri i grupit duhet të ketë min 40% të mbështetjes bankare), Pjesën e II-te 3,400,000.00 euro*

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

*Deklaratë nga banka që dëshmon se OE për realizimin e këtij projekti, ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtëzuar, (dokumenti të leshohet vetëm në emër të këtij projektit) jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar.*

*Rregullore Nr.001/2022, për Prokurimin Publik*

*Neni 40.6 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

*Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:*

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të DT;*
- b. është në pajtueshmëri me termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;*
- c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.*

Ekziston dyshimi i bazuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik Fitues “Pricom” SH.P.K. & “Metag Insaat Ticaret” A.Ş. & “FS C-ING” SH.P.K. & “Jaha Solar” SH.P.K. si dëshmi për kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës në vlerë prej 3,400,000.00 euro, kanë paraqitur një dokument nga Banka, i cili nuk posedon asnjë shënim premtues për qasje të pakushtëzuar në kredi apo për financim të projektit.

*\*Dëshmia është e klasifikuar nga OE si Sekret Afarist.*

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

*Ekziston dyshimi i bazuar se Konzorciumi fitues nuk i ka përmbush kërkesat minimale të përcaktuara në FDT, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar - Nr. 8.1 dhe 8.2 - Kapital të mjaftueshëm për realizimin e Kontratës në vlerë prej 3,400,000.00 euro (Letër Konfirmimi nga banka për mjete të gatshme në xhirollogari apo Letër Përkrahja për qasje të pakushtëzuar në kredi).*

*\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsytim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet e dispozitave të LPP-së, në pikën 8.*

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet “9”

*Kriteri në DT:*

*Kapaciteti Teknik dhe Profesional - Nr. 9.1 dhe 9.2;*

*Lista e kontratave të realizuara/përfunduara në lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, jo më pak se:*

*Loti II = 25,000,000.00 euro.*

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

*Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve ose referencat, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve në lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare.*

*Neni 69 i LPP-së Nr.04/L-042*

*Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale*

*4.2 (II) – kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë.*

Anëtari i Konzorciumit Fitues “Metag İnşaat Ticaret” A.Ş. me seli në Turqi, si dëshmi për Kontratën e realizuara në tri vitet e fundit, ka paraqitur vetëm një Referencë të lëshuar nga një blerës privat në Turqi “Burakcan İnşaat ve Ticaret Ltd. Sti.”. Vlera e punëve të kryera sipas Referencës është 135,416,998.89 US, kurse titulli i Projektit: “Construction of total 65,625km of the Provincial Road of Kūçüksu – Pervari between km 57+400–99+365 km 0+000-23+660”. Ky projekt kaq voluminoz nuk figuron fare në web-faqen zyrtare të Anëtarit të Konzorciumit.

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

***Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-së Nr.04/L-042, Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, pika 4.2 (II), duke e shpërblyer me Kontratë një Grup të Operatorëve Ekonomik të Pa Përgjegjshëm, që si dëshmi për Kontratën e realizuara në tri vitet e fundit, ka pranuar vetëm një Referencë të lëshuar nga blerësi privat në Shtetin Turk. Neni 69 i LPP-së, pika 4.2 e saktëson që, kur blerësi është privat duhet të bashkangjiten të gjitha dokumentet e nënshkruara nga ai (Kontrata, Situacionet, Procesverbalet e Pranimit Teknik, Faturat, Referenca etj.).***

*\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet e dispozitave të LPP-së, në pikën 9.*

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet “10”

*Kriteri në FDT:*

*Kapaciteti Teknik dhe Profesional - Nr. 9.1 dhe 9.2;*

*10. Pajisjet dhe Mekanizimi i obligueshëm, Sipas Aneksit 1, të DT;*

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

*Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Lista e pajisjeve duhet të jete e noterizuar nga Noteri sipas procedurës EN – Brevet. Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.*

*Rregullore Nr.001/2022, për Prokurimin Publik*

*Neni 40.6 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

*Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:*

*a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të DT;*

*b. është në pajtueshmëri me termat teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;*

*c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.*

Ekziston dyshimi i bazuar se Grupi i Operatorëve Ekonomik Fitues “Pricom” SH.P.K. & “Metag İnşaat Ticaret” A.Ş. & “FS C ING” SH.P.K. & “Jaha Solar” SH.P.K., në mungesë të dëshmime origjinal të pronësisë së pajisjeve të Anëtarit “Metag İnşaat Ticaret” A.Ş., para Noterit kanë paraqitur vetëm “Listën e Pajisjeve” të përpiluar nga vet ata. Një dokument i tillë, i prezantuar para Noterit pa dëshmi origjinal të pronësisë, sipas LNK-së, mund të noterizohet vetëm si kopje nga origjinali.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në FDT, që Lista e Pajisjeve të jetë e Noterizuar sipas procedurës EN – Brevet, me qëllim që pala të paraqes dëshmitë e pronësisë para Noterit.

*\*Dëshmia është e klasifikuar nga OE si Sekret Afarist.*

*Dispozitat e shkelura të LPP-së:*

*Ekziston dyshimi i bazuar se Konzorciumi fitues nuk i ka përmbush kërkesat minimale të përcaktuara në FDT, Kapaciteti Teknik dhe Profesional Nr.9.1 dhe 9.2. – Lista e pajisjeve është e noterizuar vetëm si kopje nga origjinali.*

*\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsytim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet e dispozitave të LPP-së, në pikën 10.*

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet "11"

LPP Nr.04/L-042, Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237

Neni 60.A Përparësia për Ofertuesit Vendor

2. Gjatë aplikimit të kriterit të çmimit më të ulët të ofruar, dhe në situatat me oferta të ofertuesve vendor dhe të huaj për ofrim të shërbimeve, kontratë furnizimi ose kryerje të punëve, autoriteti kontraktues përzgjedh ofertën e ofertuesit vendor me kusht që çmimi i këtij ofertuesi të mos jetë më i lartë se pesëmbdhjetë përqind (15%) në krahasim me çmimin më të ulët të ofruar nga ofertuesi i huaj.

4. Ofertuesi vendor është person juridik rezident në lidhje me kushtet e ligjit që rregullojnë tatimet në të hyra të personave juridik ose person fizik rezident në lidhje me kushtet e ligjit që rregullojnë tatimin në të hyra të qytetarëve.

5. Në rast të ofertës së përbashkët, grupi i ofertuesve konsiderohet si ofertues vendor nëse secili anëtar i grupit është person i referuar në paragrafin 4 të këtij neni.

Anëtari i Grupi Ekonomik Fitues "Metag Insaat Ticaret" A.Ş., sipas dëshmive të paraqitura në ofertë nuk është person juridik ose person fizik rezident sipas paragrafit 4, të Nenit 60.A, prandaj ky Grup Ofertues sipas paragrafit 5, Neni 60.A, të Ligjit Nr.04/L-237, konsiderohet Grup Ofertues i Huaj.

Të gjithë Anëtarët e Grupit tonë Ofertues "DAMASTION PROJECT" SH.P.K. & "COMPANYA ESKAVATORI" SH.P.K. & "B FAMIS" SH.P.K. & "ESKAVATORI MK" L.L.C., në përputhje me paragrafin 4, Neni 60.A, janë persona fizik rezident në lidhje me kushtet e ligjit që rregullojnë tatimet në të hyrat për qytetar, prandaj sipas paragrafit 5, Neni 60.A ne konsiderohemi Grup i Ofertuesëve Vendor.

Dispozitat e shkelura të LPP-së:

AK ka vepruar në kundërshtim me Paragrafin 2 të Nenit 60.A të Ligjit Nr.04/L-237, i cili specifikon se: Gjatë aplikimit të kriterit të çmimit më të ulët, në situatat me oferta të ofertuesve vendor dhe të huaj, për kontrata furnizim ose kryerje të punëve, autoriteti kontraktues përzgjedh ofertën e ofertuesit vendor me kusht që çmimi i këtij ofertuesi të mos jetë më i lartë se pesëmbdhjetë përqind (15%) në krahasim me çmimin më të ulët të ofruar nga ofertuesi i huaj. Diferenca e ofertave në mes të Konzorciumit të Huaj Fitues dhe Konzorciumit tonë Vendor është më e vogël se 15%, saktësisht 7.57%.

\*Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsytim me shkrim mbi refuzimin e fakteve dhe argumenteve të paraqitura mbi shkeljet e dispozitave të LPP-së, në pikën 11.

**Propozim për nxjerrje të provave:**

Ankuesi i propozon OSHP-së që dokumentet e më poshtme të Grupit të OE Fitues "Pricom" SH.P.K. & "Metag Insaat Ticaret" A.Ş. & "FS C I N G" SH.P.K. & "Jaha Solar" SH.P.K., në të cilat AK nuk ka lejuar qasje, t'i vëjë në dispozicion të panelit, ekspertit, si dhe t'i ofrohet për ekzaminim Ankuesit, në mënyrë që të vërtetohen pretendimet ankimore.

1. Raporti i Vlerësimit të Komisionit të Parë,
2. Dëshmitë në lidhje me kërkesat e Përshtatshmërisë dhe Sigurimi Original i Tenderit
3. Dokumentin Original të Marrëveshjes së Konzorciumit,
4. Deklaratat Tatimore Vjetore për tri vitet e fundit në vlerë 34,000,000.00 euro,
5. Letër Përkrahjen nga Banka për qasje të pakushtëzuar në kredi në vlerë 3,400,000.00 euro,
6. Lista e Pajisjeve e noterizuar nga Noteri sipas procedures EN – Brevet.

Duke marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe argumentet e lartëcekura, i kërkojmë OSHP-së, që pas shqyrtimit të kësaj ankese të nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e konzorciumit "DAMASTION PROJECT" SH.P.K. & "COMPANYA ESKAVATORI" SH.P.K. & "B FAMIS" SH.P.K. & "ESKAVATORI MK" L.L.C, kurse Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt. 03.04.2024, **ANULOHET** dhe Lënda i Kthehet Autoriteti Kontraktues në RIVLERËSIM.
- II. **DETYROHET** që në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarruara lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mosrespektim të vendimit sikurse parashihet në dispozitat e nenit 131 të LPP-së.
- III. **LEJOHET** të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet Opertori Ekonomik Ankues që konform nenit 31, pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesën për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.



## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Kosto e përgatitjes së Ofertës,  
Kosto e stafit profesional të angazhuar në hartimin e ofertës,  
Kosto e stafit të jashtëm të angazhuar me kontratë për këtë projekt,  
Kosto e makinerisë me qira të angazhuar me kontratë për këtë projekt,  
Kosto e marrëveshjeve të furnizimit me kontratë për këtë projekt,  
Kosto e Sigurimit të Tenderit në vlerë 250,000.00 euro,  
Kosto e shërbimeve noteriale,  
Kosto e vlerësimit të hipotekave,  
Kosto e shërbimeve komunale për regjistrimit të hipotekave,  
Kosto e shërbimeve bankare për këtë projekt,  
Kosto e hipotekave të bllokuara për këtë projekt në vlerë 3,400,000.00 euro,  
Kosto e stafit profesional për hartimin e Kërkesës për Rishqyrtim,  
Kosto e stafit profesional për hartimin e Ankesës në OSHP,  
Kosto e fitimit të humbur etj.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

1. F01 Ankesa në OSHP – PDF,  
Faktet:
2. Faktet dhe argumentet për Deklaratën "1",
3. Faktet dhe argumentet për Deklaratën "2",
4. Faktet dhe argumentet për Deklaratën "3",
5. Faktet dhe argumentet për Deklaratën "4",
6. Faktet dhe argumentet për Deklaratën "5",
7. Faktet dhe argumentet për Deklaratën "6",
8. Faktet dhe argumentet për Deklaratën "9",
9. B05 "Njoftimi për Kontratë",
10. B54 "Korrigjimi i gabimeve",
11. B12 "Procesverbali i Hapjes",
12. Kërkesë nga AK drejtuar Konzorciumit tonë për dorëzimin e dëshmime lidhur me kërkesat e Përshtatshmërisë dhe Sigurimit origjinal – për Fituesin e Tenderit,
13. Kërkesë për Sqarim nga Konzorciumi jonë drejtuar AK, lidhur me vonesat në dërgimin e Formularit B58,
14. Letra Standarde për Tenderuesin e Pa Suksesshëm,
15. B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK,
16. Raporti i Ri-Vlerësimit,
17. Kërkesat për qasje në dokumente,
18. F02 Kërkesë për Rishqyrtim drejtuar AK,
19. Vendimi i AK mbi Refizimin e Kërkesës për Rishqyrtim,
20. Dëshmia e pagesës së tarifës së ankimimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së,
21. Autorizimi për Përfaqësim të Grupit,

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*